



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 6.5.2023

Nr: 455

Ora: 12:30

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 386 NGA SUBJEKTI “KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA” (KRIIK) PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NË KUNDËRSHTIM TË LIGJIT NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË” NË AKSIN RRUGOR KOMBËTAR TIRANË - LUSHNJË

Sot më datë 6 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

OBJEKTI: Kërkohet heqja e menjëhershme e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit në aksin rrugor kombëtar nga Tirana në drejtim të Lushnjës

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” e “n”, e pika 2, dhe neni 79, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me denoncues Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), regjistruar me nr. 386 ID të regjistrimit të denoncimeve. Nëpërmjet këtij denoncimi pretendohet se “Në aksin rrugor kombëtar nga Tirana në Lushnjë, përkatësisht në bashkitë Lushnjë, Rrogozhinë, Kavajë

Data: 6.5.2023 Nr: 455
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 386 nga KRIIK për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në aksin rrugor kombëtar Tiranë Lushnjë”

dhe Durrës, janë afishuar materiale propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë".

Pala kërkuese kërkon heqjen e menjëhershme të materialeve propagandistike të vendosura në kundërshtim me ligjin.

Në përgjigje të këtij denoncimi, KQZ fillon hetimin administrativ përkatës. Në kuadër të këtij hetimi administrativ, monitoruesit të caktuar nga KQZ për monitorimin e bashkive të sipërcituara, nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, ju kërkua informacion në lidhje me afishimin e këtyre materialeve propagandistike nëse vazhdojnë të jenë akoma të afishuara. Nga informacioni i kërkuar rezultoi se materialet propagandistike janë të vendosura në këto akse rrugore dhe nuk përmbajnë shënimin "prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të".

Në datë 03.05.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, miratoi vendimin nr. 424, "Për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin "Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ..." (vijon emri i subjektit zgjedhor) me të cilin ngarkohet Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake për heqjen e të gjitha materialeve propagandistike të cilat nuk përmbajnë këtë shënim.

Me shkresën nr. 4640 prot., si dhe nr. 4651 prot., datë 4.5.2023 i është përcjellë vendimi nr. 424, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të gjitha bashkive si dhe Policisë së Shtetit.

Pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve të bëra nga denoncuesi, si dhe raportit të monitorimit vlerësoj se materialet propagandistike janë vendosur në kundërshtim me nenin 3, pika 1, të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" e "n", e pika 2, dhe nenin 79, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore"

V E N D O S:

1. Urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për heqjen e menjëherëshme të materialeve propagandistike të subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" të vendosura në aksin rrugor kombëtar nga Tirana në Lushnjë, respektivisht në bashkitë Tiranë, Durrës, Rrogozhinë, Kavajë dhe Lushnjë.
2. Ky vendim t'u njoftohet subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", Policisë së Shtetit, si dhe policive bashkiake Tiranë, Durrës, Rrogozhinë, Kavajë dhe Lushnjë nëpërmjet postës elektronike.

Data: 6.5.2023 Nr: 455
Ora: 12:30



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 386 nga KRIIK për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" në aksin rrugor kombëtar Tiranë Lushnjë"

3. Ngarkohen Policia e Shtetit dhe policitë bashkiake Tiranë, Durrës, Rrogozhinë, Kavajë dhe Lushnjë për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 6.5.2023 Nr: 455
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 386 nga KRIIK për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në aksin rrugor kombëtar Tiranë Lushnië”